



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr.63, datë 27.07.2009

PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT
EUROSIG SH.A

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23 të Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Pas inspektimit të kryer pranë shoqërisë “Eurosig” sh.a dhe analizës së gjendjes financiare të vitit 2008 dhe 3 mujorit të parë të vitit 2009, rezultoi se shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozita të caktuara të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”. Shoqëria është vënë në dijeni të shkeljeve të konstatuara si nga raporti përfundimtar i inspektimit (pas pasqyrimit dhe të observacioneve të shoqërisë) ashtu edhe nëpërmjet takimeve zyrtare të kryera nga Autoriteti me përfaqësues të shoqërisë. Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të sanksionojë shoqërinë e sigurimit “Eurosig” sh.a, me gjobë në masën 1,500,000 lekë, bazuar në nenin 165, pika 1, gërma d) dhe g), të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004:
 - a) për shkelje në lidhje me investimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike parashikuar nga neni 103, të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004.
 - b) për shkelje të nenit 115, të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004, në lidhje me paraqitjen e listës së dokumenteve të llogaridhënies së detajuar.

2. Të urdhërojë shoqërinë e sigurimit “Eurosig” sh.a, bazuar në nenin 124, pika 1, gërma ë) dhe nenin 125, pika 1, të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004, të hartojë një plan masash për eliminimin e shkeljeve të neneve 103, 107, 108 dhe nenit 115, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, brenda datës 30.09.2009 si dhe të paraqesë në Autoritet, një raport të detajuar për realizimin e këtij plani brenda datës 31.12.2009.
3. Të ndalojë shoqërinë të shpërndajë fitim, bazuar në nenin 111, të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004,
4. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI